



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

Rregullore për funksionimin e bibliotekës digjitale është hartuar në mbështetje të Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, në Statutin e Kolegjit nenet:62.63.64.65.66. dhe 81; si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe që është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor datë 25.09.2020, të Kolegjit BIZNESI.

## RREGULLORE PËR FUNKSIONIMIN E BIBLIOTEKËS DIGJITALE

### Neni 1

Kolegji Biznesi ka të themeluar përveq bibliotekës fizike edhe Bibliotekën digjitale.

Biblioteka vepron duke respektuar plotësisht te drejtën autoriale/

### Neni 2

Biblioteka Digjitale është në funksion të studentëve të Kolegjit Biznesi.

Të gjithë studentet e Kolegjit Biznesi kanë mundësi të shfrytëzojnë bibliotekën fizike dhe librarin digjitale.

### Neni 3

Biblioteka Digjitale është e qasshme prej të gjithë studentëve 24 orë.

### Neni 4

Biblioteka Digjitale është e pajisur me materiale të shumta profesionale , libra elektronik si dhe demonstrime pune vizuale ne drejtime specifike të punës praktike.

### Neni 5

Biblioteka Digjitale ka shumë materiale praktike dhe video praktike pune nga fusha e emergjencave , ekonomikut dhe Juridike.

### Neni 6

Biblioteka Digjitale azhurnohet në mënyrë të rregullt me informacione të reja përkatësisht revista shkencore me kredibilitet të lartë profesional.

Neni 7

Biblioteka Digjitale ofron mundësi të rregulltë dhe websitet ndërkombëtare dhe ka lidhje që mund të shfrytëzohen direkt materiale shkencore , me Bibliotekën Kombëtare.

Neni 8

Biblioteka Digjitale mund të shfrytëzohet nga hulumtuesit dhe bashkëpunëtorët e Kolegjit Biznes.

Neni 9

Biblioteka Digjitale ofron qasje specifike ne materiale tjera pa pagesë për studentet.

Neni 10

Biblioteka Digjitale përbëhet nga material të klasifikuara në bazë të alfabetit dhe qasja është shumë e shpejt dhe shumë efikase e studentëve.

Prishtinë ,me 25.09.2020

Dekani

---

/ Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/